



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 nr 351-9394/20

Date 21.04.2020

KONTRATA PUBLIKE nr. 12/2020

, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; Nr Bisnesi 0700032, Nr Fiskal 600219366 , qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi

dhe

NNT " SHKODRANI (Ramadan Sha. Gashi B.I.) Nga Klina dhe " **BUJAR SHABANI B.I.** nga FERIZAJ , Qe ne baze te marrëveshjes se Konzorciumit Lider dhe bartës i Kontrates eshte caktuar SHKODRANI (Ramadan SH.Gashi B.I.) me seli ne KLINE Komuna KLINE , Nr. Biznesi numer Fiskal 811244186 , qe perfaqesohet nga pronari z. RAMADAN GASHI

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për PUNET në vijim:

ASFALTIMI I RRUGES DHE INFRASTRUKTURES **NENETOKESORE NE POTERQ- FAZA DYTE**

me numër identifikues: 634-19-4428-5-2-1/INT.634-19-044-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e PUNEVE në vijim:



1.2. Vlera Totale e Kontrates me TVSH dhe taksa tjera eshte 249.317.60€
(Dyqindedyzetenenetmijetreqindeshatetmebdhjeteuroe60/100)

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë i përditshëm sipas përshkrimit të detyrave nga neni 1 i kësaj kontrate është **100 dite pune**.

2.2 Vendi i kryerjes së punëve sipas Projektit në keto Lokalitete Poterq i Eperme :

**Neni 3 Çmimi.. Çmimet vlejne per Njesi sipas Realizmit nga Paramasat e oferets
financaire**

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali (me TVSh)
1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve sipas projektit. Të caktohen pikat gjeodezike të projektit nga ekzekutuesi i punimeve para fillimit të punimeve.	11.80	1.00	TOTAL	11.80
2	Shënimi i trases, bartja e elementeve nga projekti në teren.	0.12	3,915.00	m'	461.97
3	Pastrimi i terenit nga objektet ekzistuese në dy anet Largimi i pengesave në rrugë si barishtave, shkurreve drunjeve etj.	0.12	3,915.00	m'	461.97
4	Egzaminimi i materialeve dhe bazës së rrugës për dhe pas vuarjes në vepër të tyre si psh. Asfaltit , gurit dhe elementeve tjera për shqyrtim. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe përdorjen e materialit para fillimit të punimeve.	944.00	1.00	p.s.	944.00
5	Germimi i dheut në gjerësi me makinë në teren të kat. III dhe IV, ngarkimi dhe transporti deri në një vend të caktuar ku e cakton nga organi mbikëqyres.	0.50	5,472.00	m3	2,711.923
6	Planifikimi dhe nivelizimi i nënbazës sipas profileve në projekt si dhe ngjeshja e saj me cilindër deri në masë të kërkuar sipas normave dhe standardeve për këtë lloj pune (Mt 400 kg cm2) 3300X6+617X4	0.12	18,240.00	m2	2,152.32
7	Punimi i bankinave në dy anet e rrugës Nivelizimi i tokës me saktësi 3cm, ngjeshja me vibro-cilindër Ms=300Kn m2, furnizimi me material vendor-rrethor me përmbajtje gurore që i përgjigjet kualitetit për bankina, transporti, planifikimi me trashësi 10cm në gjendje të ngjeshur, gjëresia e bankinës 1.00m, llogaria është bërë për m'.	0.35	3,915.00	m'	1,385.91

8	Punimi i kanalit të hapur anësor për largimin e ujërave atmosferik në formë trapezi sipas detajit të dhënë në projekt.	0.40	3,915.00	m'	1,570.698
9	Punimi i lëshësave, pjeseve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna në projekt. Në çmim është llogaritur hapja e kanalit, furnizimi dhe vendosja e reres, furnizimi dhe vendosja e gypit prej betoni të armuar me punim të bazës dhe mbështjellësit prej betoni dhe i kokave hyrëse-dalëse, komplet për m'.	15.00	36.00	M	539.921
10	Punimi i lëshësave, pjeseve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna në projekt. Në çmim është llogaritur hapja e kanalit, furnizimi dhe vendosja e reres, furnizimi dhe vendosja e gypit prej betoni të armuar me punim të bazës dhe mbështjellësit prej betoni dhe i kokave hyrëse-dalëse, komplet për m'.	20.00	30.00	M	600.03
11	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e shtresës së zhavorrit për stabilizimin e bazës me fraksion 0-150 në pjesën e nevojshme të rrugës së zgjeruar me trashësi d=30cm në gjendje të ngjeshur, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mt 600 kg cm ²). Gjithashtu duhet të behen matjet gjeomekanike nga kompani e licencuar për matje. Distanca në mes matjeve sipas normave dhe standardeve.	2.36	1,600.00	m ³	3,776.00
12	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 0-63 mm me trashësi të shtresës d=25cm në gjendje të ngjeshur, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25 t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mt 600 kg cm ²). Gjithashtu duhet të behen matjet gjeomekanike nga kompani e licencuar për matje. Distanca në mes matjeve sipas normave dhe standardeve. 2580X5X0.25+1335X4X0.20	4.48	4,300.00	m ³	19,281.20
13	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 0-31,5 mm me trashësi të shtresës d=15cm në gjendje të ngjeshur, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25 t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mt 800 kg cm ²). Gjithashtu duhet të behen matjet gjeomekanike nga kompani e licencuar për matje. Distanca në mes matjeve sipas normave dhe standardeve. 2580X5X0.15+1335X4X0.10	5.90	2,464.00	m ³	14,537.60
14	Furnizimi, transporti shtruarja dhe ngjeshja e reres me trashësi 3 cm para shtruarjes së asfaltit.	4.01	445.00	m ³	1,785.34

15	Furnizimi, transporti, nivelizimi dhe shtrirja e shtresës nga asfaltbetoni AB 16 me trashësi të shtresës d=8cm ne gjendje te ngjeshur-kompaktesuar, ngjeshja me cilindër 12t sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune. 2580X4+1335X3	8.00	14,350.00	m2	114,805.74
16	Furnizimi,transporti dhe punimi i pllakes se ures me derrase te kualitetit te lartë. Në çmim te parashihet lyerja e derrases dhe elementet montuese t=5cm	295.00	70.00	m2	20,650.00
17	Furnizimi,transporti dhe vendosja e trajeve nga druri i kualitetit te lartë me dimension 10 15.Ne llogari te parashihet lyerje e trajeve dhe veshja me llamarinë t=2mm si dhe materiali montues.	295.00	1.00	m3	295.00
18	Pastrimi i terenit pas perfundimit te gjitha punimeve	0.20	3,915.00	m'	785.349
19	Hapja e kantierit që përfshin të gjitha objektet e nevojshme për përcjelljen e ndërtimit të objektit.	11.80	1.00	paushall	11.80
20	Pastrimi i terenit pergjate trases se kanalizimit nga te gjitha pengesat si shkurret, lisat dhe te tjera	0.12	3,260.00	m'	384.68
21	Riincizimi i trasës. Para fillimit të punimeve duhet të bëhet riincizimi i trasësë kanalizimit dhe definimin numerik të saj me të gjithë elemente e domosdoshëm (thyrjen horizontale, lidhjet etj)	0.20	3,260.00	m'	653.956
22	Gërmimi i dheut me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.80m. Trasa duhet t'i përgjegjet kushteve të projektit. Gjatë gërmimit të kanalit menjëherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalin në sipërfaqe, ashtu që çasja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar ura për kalimin e punëtorëve në disatncë të nevojshme. Nëse gjatë gërmimit hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritët gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali. me makine 90%	0.59	6,468.00	m3	3,816.12
23	Gërmimi i dheut me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.80m. Trasa duhet t'i përgjegjet kushteve të projektit. Gjatë gërmimit të kanalit menjëherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalin në sipërfaqe, ashtu që çasja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar ura për kalimin e punëtorëve në disatncë të nevojshme. Nëse gjatë gërmimit hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritët gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali. me makine dore 10%	1.00	640.00	m3	641.92
24	Sigurimi i kanalit nga shembja. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, në të dy anët e kanalit.	0.12	2,350.00	m'	277.30
25	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	0.12	3,260.00	m2	384.68

26	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar në deponi në vend që është caktuar nga organi mbikqyrës mbi 5km.	1.00	2,120.00	m3	2,126.36
27	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës në fundin e kanalit anash dhe mbi tub 15cm dhe ngjeshja në shtresa.	4.00	1,280.00	m3	5,120.256
28	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, për mbushjen e kanalit në pjesën ku kanalizimi punohet përgjatë konstruksionit të rrugës dhe ku kemi mbushje. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%.	4.00	840.00	m3	3,360.168
29	Mbulimi i kanalit me materialin e gërmuar nga kanali në shtresa 30cm me ngjeshje adekuate.	0.35	3,503.00	m3	1,240.062
30	Largimi i ujërave nëntokësore nga kanali nese paraqitet gjatë gropimit me pompa.	23.60	1.00	paushall	23.60
31	Prerja e asfaltit dhe rikthimi në gjendjen e mëparshme me asfalt. Në asfalt duhet të ketë kujdes sepse është një kanal nga betoni i cili duhet të ruhet, në rast të demtimit duhet që të rregullohet.	10.03	50.00	m2	501.50
32	FURNIZIM I INSTALIMIT I GYPAVE PESN4 O 315 - fekal SN4	7.01	1,434.00	m'	10,051.193
33	FURNIZIM DHE INSTALIM I GYPAVE PESN4 O 250 - fekal SN4	5.00	1,568.00	m'	7,845.018
34	FURNIZIM DHE INSTALIM I GYPAVE PESN4 O 250 - fekal SN8	5.00	50.00	m'	250.16
35	FURNIZIM DHE INSTALIM I GYPAVE PESN4 O 200 - fekal SN4	3.01	208.00	m'	625.872
36	Vendosja e shiritit sinjalizues. Shiriti duhet të vendoset min 50cm mbi gyp. Në këtë gyp duhet të shkruhet në gjuhën shqipe KUJDES GYP I KANALIZIMIT	0.12	3,260.00	m'	384.68
37	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C- 20 25 d=20cm	23.60	34.50	m3	814.20
38	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.	23.60	25.88	m3	610.768
39	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar O1000 1000mm (elemente të parafabrikuara).	35.00	158.00	copë	5,529.81
40	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit O1000 700 600mm (elemente të parafabrikuara).	25.00	88.00	copë	2,200.37

41	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës O19 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	0.24	352.00	copë	83.072
42	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, më aftesi mbajtëse 40t. Në çmim të llogaritët edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20 25.	76.70	31.00	copë	2,377.70
43	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej betonarme. Në çmim të llogaritët edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20 25.	11.80	57.00	copë	672.60
44	Furnizimi, transporti, montimi dhe gypit metalik O400 per kalimin e rruges se asfaltuar. Në çmim te llogaritët edhe shpimi I rruges ne vendet e caktuara.	94.40	8.00	m'	755.20
45	Furnizimi, transporti, montimi dhe gypit metalik O300 per kalimin e rruges se asfaltuar. Në çmim te llogaritët edhe shpimi I rruges ne vendet e caktuara.	70.80	24.00	m'	1,699.20
46	Furnizimi, transporti, montimi dhe gypit metalik O250 per kalimin e rruges se asfaltuar. Në çmim te llogaritët edhe shpimi I rruges ne vendet e caktuara.	70.80	8.00	m'	566.40
47	Testimi i rrjetit të kanalizimit në joujëleshueshmëri, gjithnjë sipas kushteve teknike të paraqitura për këtë lloj pune.	0.12	3,260.00	m'	384.68
48	Menjanimi I shtreses se humusit 20-30 cm nga siperfaqja e tokes dhe deponimi I tij anash.	1.00	50.00	m3	50.15
49	Gërmimi me makinë në token e kat. III-IV për formimin e gropes ndertimore te gropes sepike dhe puseve filtruese, si dhe planifikimi I materialit tepricë në terenin e afert.	1.00	450.00	m3	451.35
50	Mbulimi me dhe nga germimi I gropes ne mes te gropes sepike dhe terenit.	0.35	170.00	m3	60.18
51	Planifikimi dhe pastrimi I terenit në vendin e punishtes pas ndertimit të gropes sepike, puseve filtruese dhe pergjatë kanalit.	0.35	144.00	m2	50.976
52	Furnizimi, transporti dhe planifikimi I zhavorit d=20cm nën pllakën e poshtme me ngjeshje të plotë	5.90	25.00	m3	147.50
53	Betonimi I themeleve në formë shiritore me betonarme C-25 30 me armaturë 6 12mm dhe stafa 8 20cm.	50.00	8.00	m3	399.973
54	Betonimi me betonarme I pllakes se poshtme me C-25 30. Armaturë rrjetë në dy zona 10 15cm, d=20cm.	50.00	19.20	m3	959.935

55	Betonimi me betonarme I mureve në kallupe me C-25 30. Armaturë në dy zona 12 15cm, trashësia e murit d=20cm.	50.00	27.40	m3	1,369.907
56	Betonimi me betonarme I pllakes se eperme në kallupe me C-25 30. Në çmim hyn edhe betonimi I vrimave për pastrim si dhe kapaket nga beton arma. Në çmim te hyjn edhe 5 gypa metali 150mm për ventilim. Armaturë z.p 10 20 z.e 12 20, d=20cm	50.00	19.20	m3	959.935
57	Punimi dhe montimi I kapakve nga betonarme C-25 30 sipas detalit në projekt komplet me muret mbajtëse.	11.80	5.00	cope	59.00
58	Thurja e gropes septike me profila nga metali 60 60mm si shtylla dhe si thurje tel gjemba në 10 rende (8+2) . Shtyllat vendosen në baza të betonit C-25 30 me dim.30x30x50cm. Me gjatësi 1.70+0.40=2.10m. Lartësia e thurjes është 1.70m nga toka me distancë të htyllave 1.50m. Çmimi te llogaritet komplet me material dhe punë. (21.0+8.0)x2	3.01	52.00	m'	156.468
59	Blerja, transporti dhe vendosja e curve të thyer ose zhavor të trashë në pusët filtruese me madhesi 60-100mm.	4.13	55.00	m3	227.15
60	Punimi I hidroizolimit te mbrendshem me hidrouall ose me material adekuat te qendrueshem ndaj fekaeve	2.36	255.00	m2	601.80
61	Ndertimi I kokes dalese te gypit me beton arme C-25 30 në tërësi sipas detalit në projekt. Paguhet komplet me material dhe pune per nje kokë.	100.30	1.00	cope	100.30
62	Menjanimi I shtreses se humusit 20-30 cm nga siperfaqja e tokes dhe deponimi I tij anash.	1.00	30.00	m3	30.09
63	Gërmimi me makinë në token e kat. III-IV për formimin e gropes ndertimore te gropes septike dhe puseve filtruese, si dhe planifikimi I materialit tepricë në terenin e afert.	1.00	216.00	m3	216.648
64	Mbulimi me dhe nga germimi I gropes ne mes te gropes septike dhe terenit.	0.35	40.00	m3	14.16
65	Planifikimi dhe pastrimi I terenit në vendin e punishtes pas ndertimit të gropes septike, puseve filtruese dhe pergjatë kanalit.	0.35	72.00	m2	25.488
66	Furnizimi, transporti dhe planifikimi I zhavorit d=15cm nën pllakën e poshtme me ngjeshje të plotë	50.00	6.00	m3	299.98
67	Betonimi I themeleve në formë shiritore me betonarme C-25 30 me armaturë 6 12mm dhe stafa 8 20cm.	50.00	8.50	m3	424.971

68	Betonimi me betonarme I pilakes se poshtme me C-25 30. Armaturë rrjetë në dy zona 10 15cm, d=20cm.	50.00	10.00	m3	499.966
69	Betonimi me betonarme I mureve në kallupe me C-25 30. Armaturë në dy zona 10 15cm, trashësia e murit d=20cm.	50.00	15.00	m3	749.949
70	Betonimi me betonarme I pllakes se eperme në kallupe me C-25 30. Në çmim hyn edhe betonimi i vrimave për pastrim si dhe kapaket nga beton arma. Në çmim te hyjn edhe 5 gypa metali 150mm për ventilim. Armaturë z.p 10 20 z.e 12 20, d=20cm	50.00	10.00	m3	499.966
71	Punimi dhe montimi i kapakve nga betonarme C-25 30 sipas detalit në projekt komplet me muret mbajtëse.	20.00	3.00	cope	60.003
72	Thurja e gropes septike me profila nga metali 60 60mm si shtylla dhe si thurje tel gjemba në 10 rende (8+2) . Shtyllat vendosen në baza të betonit C-25 30 me dim.30x30x50cm. Me gjatësi 1.70+0.40=2.10m. Lartësia e thurjes është 1.70m nga toka me distancë të htyllave 1.50m. Çmimi te llogaritet komplet me material dhe punë. (21.0+8.0)x2	3.54	34.00	m'	120.36
73	Blerja, transporti dhe vendosja e kurve të thyer ose zhavor të trashë në pusët filtruese me madhesi 60-100mm.	5.90	40.00	m3	236.00
74	Punimi i hidroizolimit te mbrendshem me hidrouall ose me material adekuat te qendrueshem ndaj fekaleve	2.36	125.00	m2	295.00
75	Ndertimi i kokes dalese te gypit me beton arme C-25 30 në tërësi sipas detalit në projekt. Paguhet komplet me material dhe pune per nje kokë.	100.30	1.00	cope	100.30

3.1 Çmimet njësi të puneve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 1.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kryesit të punimeve sipas kontratës publike.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike .

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

3.5.Dhe ate me fature dhe Raport mbi kryerje te puneve , Jo me larg se 30 dite pas pranimit te fatures dhe Raportit .

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3. Pagesat do të ekzekutohen me keste sipas dinamike së kryerjeve të punimeve.

4.4. Projekti do të financohet nga Ministria e Infrastruktura dhe atë në Vitin 2020
ne vlerë prej 100.000.00 €
dhe në vitin 2021 pjesa tjetër prej 149.317.60 €

4.5. Pagesat do të behen sipas situacineve mbi kryerje të punimeve me Raport nga Komisioni dhe Fatura. Jo më tepër se 30 dite pas pranimit të fatures dhe Raportit .

4.5. Kesti –perfundimtare ne vlerë 24.913.76 € , pas afati të Garancionit të punimeve , perkatesisht pas 12 muajeve .(Kjo vlerë mund të paguhet me pelqimin dypaleve me garancion bankar me validitet per periudhen garantuese .

-

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i puneve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit. Kjo do të kërkohej me Atest për materjalet e përdorura .

6.2. Kryesi i puneve do të jete përgjegjes për Demtimet të shkaktuara me dashje apo pa kujdesi në masën e demit që do të përcaktohet nga zyrtari përgjegjes në infrastrukturen ..

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Në rast të dështimit apo vonesës në implementim , Do të penalizohet me masën 0.25% në ditë vonesë nga vlera totale e kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, dhe të shikoj furnizimet e bërë nëse është në masën e cilesive të kërkuara .

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore _dega Kline në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Komunikimi

12.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë

12.2 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


Neni 6. Menaxhimi i projektit dhe menaxhimi i kontrates .

6.1. Menxhimi i projektit do te behet nga njesia kërkuuese –Implementuese Drejtoria Urbanizmit Komuna Kline

6.2 Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontrtaes me vendim te ZKA do te jete : _____ nga

6.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët **Shqipe** në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues
KOMUNA KLINE**

Emri:	ABAZ FONIQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	21.04.2020
Vula:	

**Për Ofruesin e Shërbimeve :
SHKODRANI – KLINE**

Emri:	RAMADAN GASHI
Pozita:	PRONAR
Nënshkrimi:	
Data:	21.04.2020
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjesë të tyre.
- 1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjesë të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që bën Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forcë Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkolje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektivit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdorisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënua për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;(i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës; (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbyshur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe afërsitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbim parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancooni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike komizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që flogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes së kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta


KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <u>LORENC MARLEKU – DREJTORIA E URBANIZMIT</u> <u>MENXHER I KONTRATES ESHTË</u> <u>NGA</u> <u>Drejtoria</u>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: 10 % vlerës së kontratës, PERKATESISHTE VLERA 24.931.76 € ME AFATE 100+30=130 dite kalendarik
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates b) Përgjegjësia e pales së tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates d) Përgjegjësia profesionale 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është gja tere kohes se Validiteit te Kontrates.
Afati i Implemtimit	17.2	Plani i plementimit te projektit 100 dite pune .
Mos realizimii apo sanksionet	17.3	Per cdo dite vonese do te sanksionohet 0.25% ng vlere e kontrates per dite vonese.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Do te përpiqet qe me pajtueshmëri te dy paleve te zgjidhen problemet .
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore Peje – Dega Kline në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

Shitës:
KOSOVA ASFALT "SHPK"
Tel: 049-142-143
NRB. 71264726
Ferizaj



Blerës:
NPSH „BAGERI“
Tel. +377 44 124 481
NRB 80280343
Ferizaj
bageri-company.com



Bageri
08.03.2019

Marrëveshje

furnizimi me asfalt

Me këtë vërtetojmë marrëveshjen e Shitjes së asfaltit sipas recepturave ndërmjet NPSH „BAGERI“ nga njëra anë si blerës dhe kompanisë KOSOVA ASFALT Shpk nga Ferizaj si shitës në anën tjetër.

Kjo marrëveshje garanton furnizimin me materijalin e cekur më lartë në qdo kohë dhe në tërë teritorin e Kosovës dhe hynë në fuqi nga data e firmosjes së saj nga ana e të dy palëve dhe është valide deri më 31.12.2019 për të gjitha projektet e Npsh Bagerit :

Blerës :
NPSH „BAGERI“
Bujar Shabani
Bujar Shabani



Shitës :
KOSOVA ASFALT Shpk
Valdrin Shabani
Valdrin Shabani





Republika e Kosovës
NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

Akt en brevet.nr.rend.3823/2019

VËRTETIM KOPJE nga Originali

Sot më datën 16.05.2019 (gjashtembdhjete maj dymije e nentembdhjete) në zyrën e noterit Zyfer Aliu në Lipjan,Rr."Lidhja e Prizrenit p.n.u paraqit:-----

1.Z.Bujar Shabani, nga I ati Islam, i lindur në Gaçkë-Ferizaj , me dt. 28.12.1967(njezet e tetë dhjetor njemij e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë), me vendbanim në F.Gaçkë-Ferizaj, shtetas i Rep. së Kosovës,bartës i Leternjoftimin me numer personal 1003510855, të lëshuar nga MPB-Prishtinë me date 22.02.2010, valid deri më 22.02.2020, madhor, me aftësi të plotë veprimi: -----

I lartë përmenduri ka kërkuar nga Noteri:-----

Vërtetimin e dokumentit të sjellur në zyren e noterit, dokumenti I quajtur "Marreveshje furnizimi me asfalt " e dt. 08.03.2019 e lidhur ndermjet KOSOVA ASFALT SHPK dhe NPSH BAGERI -----

Dokumenti përmban 1 fletë dhe 1 faqe.-----

Dokumentin e percaktuar nga pala si original, e ka sjellë vetë ai dhe të njejtin e tërëhjek me kopjen e vërtetuar. Noteri nuk mban përgjegjësi për permbajtjen e dokumentit që është sjellur nga pala në zyren e tij noteri vërteton vetem kopjen nga origjinali,-----

Noteri, në kuptim të nenit 46 të LNK vërteton dokumentin kopje nga origjinali, që është sjellur në zyren noteriale në Lipjan-----

Ky akt lëshohet en bevert, Tarifa është paguar sipas UA mbi tarifat e përkohshme noteriale për çdo fletë nga 1€ + 18% =1.18€ (nje euro e 18/100)-----

Lipjan me datën 16.05.2019 (gjashtembdhjete maj dymije e nentembdhjete) -----





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGENCIJA KOORDINATORI TE BIZNESIT NE KOSOVE
KOORDINATING AGENCY FOR BUSINESS IN KOSOVO

CERTIFIKATE E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

811052646

Numeri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

KOSOVA ASfalt SHUPITK

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:


Pn
Gaçkë
Feriza]

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

05/04/2016

28/02/2019

Data / Date / Datum



[Signature]

Nënshkrim / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10003168



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) në pajtim me nenin 6, 39, 40, 59 dhe 62 të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163 dhe Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimet dhe Plotësime të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, në mbledhjen e mbajtur më datën 14.07.2018, ka marrë vendim të mëposhtme:

Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale (NKRM) u skladu s Članom 6, 39, 40, 59 i 62 Zakona o Rudnicima i Mineralima br. 03/L-163 kao i Zakona br. 04/L-158 za Promene i Dopune Zakona br. 03/L-163 za Rudnike i Minerale, na održanoj sednici sa datumom 22/06/2018. izdala ovaj nalog u skladu sa "Commission for Mines and Minerals (ICMM) in accordance with article 6, 39, 40, 59 and 62 of the Law on Mines and Minerals no. 03/L-163 and the Law no. 04/L-158 on Amending and Supplementing the Law no. 03/L-163 on Mines and Minerals, in the meeting held on 22/06/2018 hereby issues this:


LEJE PËR AKTIVITETET E VEÇANTA
DOZVOLE ZA POSEBNE AKTIVNOSTI / SPECIAL OPERATIONS PERMIT
609/KPM/2018

Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of Business:	"KOSOVA ASFALT" S.R.L.
Numri i Biznesit / Br. Biznisa / Business No:	71264726
Nr. i Regjistrimit / Br. Registracije / Registration No:	908
Prindar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner:	Valdrin Shaban
Kohëzgjatja / Trajanje / Duration:	10/07/2023
Emri i vendit / Ime mesta / Site name:	Liplan
Komuna / Opština / Municipality:	Liplan
Sipërfaqja / Površina / Surface area:	22933.61 m ²
Leje për / Dozvola za / Permit for:	baza e asfaltit / osnova za asfalt / asphalt base

Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obaveze / Rights and obligations:

Kompania obligohet të përmbushë kushtetë të kësaj Leje dhe obligohet të përmbushë detyrimet sipas nenit 41 të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163 dhe Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimet dhe Plotësime të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale. Kompania është detyruar të përmbushë kushtetë dhe detyrimet të kësaj Leje dhe obligohet të përmbushë detyrimet sipas nenit 41 të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163 dhe Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimet dhe Plotësime të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

Company is obliged to comply with the terms of this Permit and is obliged to fulfil its obligations under article 41 of the Law on Mines and Minerals no. 03/L-163 and the Law no. 04/L-158 on Amending and Supplementing the Law no. 03/L-163 on Mines and Minerals.



Emri i Komisionit / Naziv Komisije / Name of Commission:
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Nr. Prot./Br. Prot./Prot. No.: 2732

Data / Datum / Date: 14.07.2018



Republika e Kosovës
NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

Akt en brevet.nr.rend.5725/2019

VËRTETIM KOPJE nga Origjinali

Sot më datën 27.06.2019(njezet e shtate qershor dymije e nenembedhjetë) në zyrën e noterit Zyfer Aliu në Lipjan,Rr."Lidhja e Prizrenit p.n.u paraqit:-----

1.Z.Valdrin Shabani, nga i ati Bujar, i lindur në Gjilan, me datë 14.05.1996(katërmbëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë), me vendbanim në F.Gaçkë-Ferizaj, shtetas i Rep së Kosovës , bartës i Leternjoftimit me numër personal 1230356234, të lëshuar nga MPB-Prishtinë, madhor me zotësi të plotë veprimi -----

I lartë përmenduri ka kërkuar nga Noteri:-----

Vërtetimin e dokumentit të sjellur në zyrën e noterit, dokumenti I quajtur "leje per aktivitete te veqanta" me nr.prot.2733 e dt. 14.08.2018 lëshuar nga KPMM per Kosova Asphalt SHPK-----

Dokumenti përmban 1 fletë dhe 1 faqe.-----

Dokumentin e percaktuar nga pala si original, e ka sjellë vetë ai dhe të njëjtin e tërë me kopjen e vërtetuar. Noteri nuk mban përgjegjesi për përbajtjen e dokumentit që është sjellur nga pala në zyrën e tij noteri vërteton vetem kopjen nga origjinali,-----

Noteri, në kuptim të nenit 46 të LNK vërteton dokumentin kopje nga origjinali, që është sjellur në zyrën noteriale në -----
Lipjan-----

Ky akt lëshohet en bevert, Tarifa është paguar sipas UA mbi tarifat e përkohshme noteriale për çdo faqe nga 1€+18% =1.18€ (nje euro e 18/100)-----

Lipjan me datën 27.06.2019(njezet e shtate qershor dymije e nenembedhjetë) -----

NOTER
Zyfer Aliu



N.N.T"SHKODRANI" PER MENAGJER NE PROJEKTIN

Nr i prokurimit	634-19-4428-5-2-1
Nr i brendshëm	634-19-044-521

Titulli: ASFATLIM I RRUGES DHE INFRASTRUKTURES NENETOKESORE NE
POTERQ- FAZA DYTE

**EMNON INZHINJERIN E NDERTIMTARIS
NESUHI DODA**

N.N.T"SHKODRANI"

RAMADAN GASHI



KLINË, Fshati Çabiq
Tel : 044 158 019
NRB i shitesit: 70554518

TITULLI: ASFATLIM I RRUGES DHE INFRASTRUKTURES NENETOKESORE NE POTERQ- FAZA DYTE



**Deklaratë e Garantuesit**

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 82033

Për Kuvendi Komunal Kline

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Ramadan Sha. Gashi B.I., N.N.T. " Shkodrani"**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **ASFALTIMI I RRUGES DHE INFRASTRUKTURES NENTOKESORE NE POTERQ -FAZA E DYTE**

Nr. prokurimit: 634 19 044 521

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit,

dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **24,931.76€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **24,931.76€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsye ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 120 ditë kalendarike prej **10.04.2020** deri më **08.08.2020**

Data lëshimit: 10.04.2020

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tingë Ismaj" nr.3,
Tel: +381 (0) 38 221 112; Fax: +381 (0) 38 221 115, E-mail: office@grawedisig.com

<https://apsig.kselsig.com/garancionet/polica/1020299>

Gjithcka që duhet ta keni

Nr. Policēs
Policy no.

82033

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË TENDERIT DHE EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS
BID BOND AND PERFORMANCE BOND POLICY

Kontraktuesi: [REDACTED]

Përfaqsuar nga: [REDACTED]

Adresa: Ramadan Sha. Gashi B.I., N.N.T. " Shkodrani"

Nr. i Biznesit: Ramadan Gashi Nr. i telefonit: [REDACTED]

Garantuesi: Fshati Çabiq Klinë

Banka e Garantuesit: 811244185

Përfutuesi: Elsig

Adresa: NLB

Shume e Sigurimit: Kuvendi Komunal Kuvendi i Marrëveshjes: [REDACTED]

Aktiviteti Ekonomik: Rr.Abedin Rexha pr
24.931.76

Data e fillimit: [REDACTED] Data e përfundimit: [REDACTED] Ora: [REDACTED]
ASFALETI RRUGES DHE INFRASTRUKTURES
NENTOKESORE NE POTERQ -FAZA E DYTE

Primi: [REDACTED] TVSH: [REDACTED] Gjithsej: [REDACTED]
2020-04-10 00:00:00 2020-08-08 00:00:00

Mënyra e pagesës: [REDACTED] Nr. i llogaritjes: [REDACTED]
299.19 53.85 353

Data e fshimit: [REDACTED]

Ne llogaritjes: 1701001011295733

Lënda e garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

1. Mbështetetur në këtë Police - Garancie, Siguruesit / Garantuesit mere përspër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë police.
2. Përfutuesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfutuesit, Siguruesit / Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfutuesit (cedimi i të drejtave nga Përfutuesi të Siguruesit / Garantuesit).
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe egzekutimit të kontratës të citat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
5. Për police të sigurimit - Egzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e egzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfutuesi) dhe Operatorit Egzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Nr i Serisă

0050718

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit të ruaj të dhënat e mia personale/të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police je sigurimur, nënshkrimet tuje në ligurimin me vullnet të arë, të pabarabardë dhe me mirëbesim kam pranuar pranim të sigurimit, kam lexuar, kuptuar mirë pranimin, kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I, the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions.

Signifies: The Insurer

8-2-15

I Sigurðar / The Insured



PLANI PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS

Sipas Nenit 81.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042

Data e përgatitjes së PMK¹ 21.04.2020

Përgatitur nga: **vendos emrin dhe mbiemrin e Menaxherit të Projektit të AK-
-DREJTOR I DREJTORISE SE URBANIZMIT - KLINE**

Numri i Prokurimit	634-19-4428-521/634-19-044-521		
Titulli i Kontratës	ASFALTIMI I RRUGEVE DHE INFRASTRUKTURES NENETOKESORE NE POTERQ- FAZA DYTE		
Punë/Shërbime/Furnizime	Viti Buxhetor	Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit	
PUNE	2019	ABAZ FONIQI	

Ngjarjet/Rezultatet e Kontratës	DETAJET E IMPLEMENTIMIT Afatet 100 DITE PUNE VLERA. 249.317.60€
Pjesët nën 'Detajet e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Vendos Nuk Aplikohet për ato që nuk janë relevante	
I. Fillimi/ Mobilizimi i Kontratës	
Njoftimi për fillimin e punës/shërbimeve/furnizimit të mallrave	MENJEHERE
Afati i përmbushjes	PLANI IMPLAEMENTIMIT -KONTRAZE 36 FILLON SE IMPLENTUARA NGA DATA E NENSHKRIMIT TE KONTRATES 100 DITE PUE

¹ Plan i Menaxhimit të Kontratës është dokument i gjallë i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. Plan i Menaxhimit të Kontratës është i hapur për monitorim të KRPP-së gjatë implementimit të kontratës dhe të gjitha auditimeve tjera të kryera nga organet shtetërore. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Pranimi i garancisë së performancës dhe lirimi i sigurimit të tenderit	<i>PO</i> <i>SIGURIMI I KONTRATES NE VLERE 24.913.76 EURO ME VALIDITET 130 DITE</i>
Pranimi i garancisë së pagesës në avans, nëse është e aplikueshme	<i>SKA AVANS</i>
Pagesa e avansit , nëse është e aplikueshme	<i>SKA</i>
Dorëzimet e para Shërbimet: raporti fillestarë Punët: instalimi i parë	
Shuma e dëmeve të likuiduara përfshirë kufizimin e dëmeve të likuiduara	
Periudha e përgjegjësisë për defekte	
II. Progresi i Kontratës	
Dorëzimet e Mëtutjeshme Shërbimet: raportet e progresit etj. Punët: instalimi i dytë etj.	
Bisedimet e Rregullta, nëse është e aplikueshme	
Inspektimi i punëtorive, materialeve dhe vendeve të prodhimit	
Pagesat e përkohshme apo në faza, nëse është e aplikueshme	
Reduktimi i garancive, nëse është e aplikueshme	<i>Ska avans</i>
III. Përmbyllja e Kontratës	
Dorëzimet Finale Shërbimet: Raporti Final Punët: Përfundimi i Punëve	
Pranimi/ dorëzimi	
Pagesa e Fundit	
Fondet e mbajtura	
Skadimi i garancionit/periudha e	

përgjegjësisë	
Lirimi i garancisë	

Finalizimi i Planit të Menaxhimit të Kontratës²:

Në emër të Autoritetit Kontraktues ; KK KLINE –DREJTORIA E UBANIZMIT

Nënshkrimi: 
Pozita: DREJTOR

Emri: LORENC MARLEKU

Data: 21.04.2020

Në emër të [Kontraktuesit/Ofruesit të Shërbimeve – NNT SHKODRANI - KLINE

Emri: RAMADAN GASHI

Nënshkrimi: 
Pozita: DREJTOR

Data: 24.04.2020

MENAXHER I KONTRATE NGA O.E, NESUHI DODA ING.

² Të nënshkruhet nga dy Menaxherët e Projektit

MENXHIMI I TRAFIKUT

Projekti

**ASFATLTIM I RRUGES DHE INFRASTRUKTURES
NENETOKESORE NE POTERQ- FAZA DYTE**



PËRMBAJTJA:

- a. Hyrje
- b. Planifikimi i punëve dhe çështjet operationale
- c. Kriteret e projektimit / rregullimi i qarkullimit në komunikacion
- d. Menaxhimi i incidenteve
- e. SINJALIZIMI (Mjetet e kontrollit në Komunikacion)
- f. Menaxhimi i trafikut - raporti teknik

a. HYRJE

a.1. PROPOZIMI - PËRSHKRIMI I PLANIT PËR MENAXHIMIN E TRAFIKUT GJATË REALIZIMIT TË PROJEKTIT

Menaxhimi i komunikacionit të përkohshëm (gjatë realizimit të projektit) nënkupton se kontraktori është përgjegjës për rregullimin e qarkullimit të komunikacionit në të gjitha rrugët të cilat mund të jenë në funksion gjatë zhvillimit të punimeve.

Gjatë punës në segmentin rrugor, është i nevojshëm menaxhimi i sigurt i trafikut dhe të merren masa të përkohshme për të lehtësuar punimet rrugore, mbylljen e përkohshme ose menaxhimit të incidentit, ndërsa qarkullimi i trafikut të realizohet nëpër rrugët alternative pa pengesa sa më shumë që të jetë e mundur. Punimet në rrugë ose në afërsi të një trase mund të zvogëlojnë sigurinë dhe lëvizjen e lirë të pjesëmarrësve në komunikacion.

Kontraktuesi është përgjegjës për rregullimin e qarkullimit të komunikacionit në të gjitha rrugët publike të cilat mund të jenë në funksion gjatë zhvillimit të punëve ndërtimore. Kjo pjesë paraqet kërkesat specifike të Projektit për kontroll të komunikacionit rrugor përmes vendpunishtes, gjë që duhet të bëhet nga Kontraktuesi.

Kontraktuesi implementon planin e Menaxhimit të Komunikacionit në përputhje me programin e përfshirë në Plan. Në baza ditore, Kontraktuesi siguron se të gjitha masat lajmëruese për ridrejtimin e komunikacionit dhe kërkesat e sigurisë janë implemtentuar para fillimit të ndonjë punë relevante sipas Kontratës.

Kontraktuesi monitoron efektshmerinë e vazhdueshme të Planit për Menaxhimin e Komunikacionit gjatë zhvillimit të Kontratës dhe duhet të përmirësoj dhe ripërtrijë Planin kur kjo është e domosdoshme.

Kur propozohet ndonjë ndryshim të aranzhimit ekzistues të komunikacionit, Kontraktuesi nese urdhërohet nga Inxhinieri i Projektit (Inxhinieri) duhet të përgatitë Planin për Menaxhimin e Komunikacionit i cili jep qartë në detaje aranzhimet e përmirësuara të komunikacionit në të gjitha lokacionet që ndikohen nga ndryshimi.

- Plani i permisuar i menaxhimit të komunikacionit duhet ti dorëzohet inxhinierit për miratimin e tij së paku 7-ditë para datës së propozuar për ri-aranzhimin e komunikacionit
- Dështimi për tu përputhur me këto kërkesa mund të rezultojnë që inxhinieri të shtyj afatin për ri aranzhimin e komunikacionit për të siguruar kohë të mjaftueshme për njoftim publikut. Një shtyrje e tillë nuk duhet të jetë shkak për vazhdimin e kohës sipas kontratës.
- Nuk do të bëhet asnjë aranzhim komunikacioni derisa të miratohet nga ana e inxhinierit, plani relevant për menaxhimin e komunikacionit.

Në vazhdim do të cekën disa pika të rëndësishme për menaxhimin e komunikacionit (të përkohshëm):

a.2. AMBIENTI, SHËNDETI DHE SIGURIA

Gjatë punimeve duhet ti jepet rëndë e veçantë ambientit.

Kompleksiteti i marrëveshjeve të menaxhimit të trafikut ndryshon nga skema të skeme, por objektivi kryesor është gjithmonë për të maksimizuar sigurinë e fuqisë punëtore dhe publikut që udhëtojnë. Prandaj është thelbësore që operacionet e përkohshme të menaxhimit të trafikut projektohen, planifikohen dhe zbatohen në përputhje me një sistem të sigurt të punës. Duke punuar në rrugët qarkulluese mbartet një rrezik potencialisht i lartë, përveç kësaj, personeli i përfshirë mund të ketë shumë pak mbrojtje nga trafiku që vjen. Prandaj puna do të menaxhohen si duhet për të siguruar që rreziqet janë aq të ulëta sa është praktikisht e arsyeshme.

Gjersa punimet janë në progres, personi, personat apo organizata përgjegjëse për punët ka obligim ndaj të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion, që të marr hapa të tillë të arsyeshme dhe të praktikueshme për t'i mbrojtur ata nga lëndimet dhe pronat e tyre nga dëmtimi. Prandaj duhet të vendosen shenja të mjaftueshme paralajmëruese, barriera dhe masa të tjera të nevojshme për të evituar ndonjë rrezik. Këto masa duhet të hiqen kur nuk është më e nevojshme.

b. PLANIFIKIMI I PUNËVE DHE QESHTJET OPERACIONALE

b.1. PARIMET E PËRGJITHSHME TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT PËR PLANIFIKIMIN E PËRKOSSHËM

Ky seksion merret me parimet e përgjithshme për menaxhimin e projektimit të trafikut të përkohshme dhe aplikimin e tij në planifikimin e skemave të punëve rrugore. Kompleksiteti i marrëveshjeve të menaxhimit të trafikut ndryshon nga skema në skeme,

- por objektivi kryesor është gjithmonë:
 - *për të maksimizuar sigurinë e fuqisë punëtore dhe publikut që udhëtojnë.*
- Objektivi sekondar është:
 - *për të mbajtur qarkullimin e komunikacionit pa dendësi si të jetë e mundur.*

b.2. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Projekti për Menaxhimin i trafikut përgatitet në përgjithësi nga ekzekutuesi i projektit kryesor (kontraktuesi), duhet të identifikojnë veprimet e propozuara dhe programin dhe të sigurojë një skicë të propozimeve të menaxhimit të trafikut.

b.3. SHËRBITET EMERGJENTE

Shërbimet e ushtrisë, policisë, zjarrfikësit dhe ambulanca duhet të konsultohen në lidhje me kohën dhe shtrirjen e punimeve, për rrugët e emergjencës përmes punëve. Në rrethana të caktuara, nuk mund të jenë organizatat e tjera që do të duhet të konsultohen në planifikimin e punimeve.

Çdo karakteristika të veçanta që mund të ndikojnë në sigurinë operationale të punimeve do të duhet të merren parasysh gjatë projektimit.

b.4. PLANI DETAL PËR MENAXHIMIN E TRAFIKUT

Pasi që punët janë në rrugën Nacionale, duke pas parasysh të gjithë faktorët, projekti për menaxhimin e trafikut udhëhiqet nga projektuesit profesional të menaxhimit të trafikut, i cili do të prodhojë skema të hollësishme duke përfshirë planet e menaxhimit të trafikut në të cilat jepen alternativa të mundshme të cilat janë vlerësuar dhe vlerësohen.

Objektivi i kryesor i menaxhimit të detajuar të trafikut është që të demonstrojnë një zgjidhje praktike për të lehtësuar kalimin e sigurt të trafikut, përfshirë edhe këmbësorë, dhe gjatë punëve për të siguruar fuqinë punëtore. Kjo kërkon një pasqyrë objektive në detaje e të gjithë faktorëve që konsiderohen më parë (p.sh. projekt i shkurtër, konsultime, dhe kufizimet) për të siguruar prodhimin e një zgjidhje të përbërë, përveç njohjes me standardet e duhura dhe shënime e këshilla, njohja e vendit dhe aftësia për të siguruar rrjedhën e trafikut përmes veprave janë më të rëndësishme.

Projektimi i menaxhimit të përkohshëm të trafikut duhet të vendoset në dokumentacion të qartë, duke përfshirë vizatime dhe specifikime, nëse është e përshtatshme, nuk duhet të përfshijë ndonjë nga vizatimet standarde, apo detaje, të cilat nuk janë të zbatueshme për skemën.

c. KRITERET E PROJEKTIMIT / RREGULLIMI I QARKULLIMIT NË KOMUNIKACION (Qarkullimi, densiteti, Kapaciteti dhe shpejtësia)

Ky seksion jep këshilla mbi çështje të përgjithshme të projektimit. Megjithatë, jo të gjitha udhëzimet e mëposhtme zbatohet për të gjitha situatat, por këto kritere duhet të ndiqen si të përshtatshme.

c.1. HAPËSIRAT E SIGURISË

Krijimi i zonave të përcaktuara mirë me gjerësi minimale të sigurisë, në të cilat punëtorët dhe mjetet nuk duhet të hyjnë në rrjedhën normale të trafikut dhe materialet nuk duhet të depozitohen, është një parakusht thelbësor për garantimin e sigurisë gjatë punimeve rrugore.

c.2. GJERËSIA E RRUGËS ALTERNATIVE

Në të gjitha rrugët alternative ekzistuese për qarkullimin e automjeteve, gjerësia e shiritit të komunikacionit është në dimensione minimale por të lejuara.

Rrugët alternative paralajmërohen paraprakisht me shenjat vertikale të komunikacionit.

c.3. QARKULLIMI DHE KAPACITETI I KOMUNIKACIONIT

Komunikacioni është me qarkullim mesatar dhe struktura e qarkullimit është e përzier (Automjete, kamionë, autobusë etj.).

Kapaciteti i një rruge është përcaktuar si numri maksimal i automjeteve në një vend kur ka një radhë.

c.4. SHPEJTËSIA E QARKULLIMIT

Në teorinë e qarkullimit në komunikacion për përshkrimin e ligjshmërisë së lëvizjes të më shumë automjeteve në rrugë, përkatësisht për definimin e shpejtësisë së qarkullimit, definicioni i njohur më parë për shpejtësinë i cili thotë „shpejtësia është rruga e kaluar në njësi të kohës“ nuk është i mjaftueshëm, por është e domosdoshme të përdoren nocionet:

-shpejtësia mesatare hapësinore e qarkullimit,

-shpejtësia mesatare kohore e qarkullimit.

Në rrugë pranë punimeve dhe rrugë alternative - planifikohet qe shpejtësia maksimale të jetë 40 (km/h)

d. MENAXHIMI I INCIDENTEVE

d.1. EMERGJENCA

Urgjencat në rrjetin e rrugëve publike trajtohen normalisht nga policia, shërbimet e tjera emergjente ose oficerët e trafikut (nëse është e përshtatshme). Nëse incidentet nuk do të zgjasin më shumë se disa orë, si në rastin e një avari të mjetit ose të një aksidenti të rëndë, policia ose zyrtarët e trafikut do të vendosin shenjat e nevojshme të përkohshme. Nëse një emergjence ndodhë brenda një seksioni të trasesë tashmë subjekt i kufizimeve si pasojë e punimeve rrugore, policia mund të kërkojnë personelin për marrëveshje.

d.2. MENAXHIMI I TRAFIKUT EMERGJENT

Në rast urgjence, menaxhimi i trafikut të përkohshme mund të mos jetë gjithmonë i mundshëm. Në rrethana të tilla mund të jetë e nevojshme për ata që kanë të bëjnë me një incident për të dislokuar menaxhimin e trafikut emergjent të përdorin këto resurse të kufizuara të menaxhimit të trafikut që janë në dispozicionin e tyre pas mbërritjes në incident.

Trafiku i Menaxhimit të Emergjencave do të bëhet vetëm qe:

- *të sigurojë mbrojtje afatshkurtër ndaj atyre që janë të përfshirë në incident;*
- *të parandaluar përshkallëzimin e incidentit;*
- *mbrojtje dhe t'i japë drejtim tjetër për trafikun qe afrohet;*
- *mbrojtje skenën e një krimi të tillë deri në kohën kur policia të marrë përsipër; ose*
- *të ndihmojë të menaxhuar incident nëse është shumë i ngjeshur.*

e. SINJALIZIMI (Mjetet e kontrollit në Komunikacion)

Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontroll të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në zgjerimet e rrugës.

Mjetet e kontrollit të komunikacionit duhet të jenë konform me gjitha Ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të aplikueshme në Kosovë dhe me kërkesat e Kontratës.

Të gjitha mjetet e kontrollit të komunikacionit duhet të mirëmbahen në kushte efektive dhe të pastërta deri sa hyn në punë sipas Kontratës. Mjetet që janë të dëmtuara apo të mveshura me tjetër gjë apo të cilat nuk janë konform me kërkesat e sipërme nuk duhet të shfrytëzohen. Shenjat Portale të komunikacionit aty ku shfrytëzohen sipas Kontratës duhet të miratohen nga Inxhinieri. Vënia e mjeteve për kontrollin e komunikacionit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Kontratës përveq kur mjetet shtesë duhet të ofrohen dhe vendosen kur tregohen në vizatime apo kur kjo urdhërohet nga Inxhinieri i Projektit (Inxhinieri).

Fillimisht në fazën e përgatitjes së punishtës dhe trasesë Kontrakti është i obliguar qe të vendos shenjat e nevojshme për kontrolle dhe orientim të trafikut në mënyrë qe trafiku të rrjedhë i pandërprerë gjatë tere kohës së ekzekutimit të punimeve. Gjithashtu duhet të vendosen edhe shenjat adekuate të

lajmërimin për punime në rrugë në distanca adekuate në fillim dhe në përfundim të trasesë si dhe përgjatë trasesë.

Punimet në trase nuk mund të fillojnë pa u vendosur këto shenja, gjithashtu këto shenja gjatë tërë kohës duhet të mirëmbahen dhe kontrollohen nga ana e kontraktorit si dhe janë subjekti i marrëveshjes me mbikëqyrësin lidhur me shtimin ose plotësimin e informacioneve për trafikun gjatë kryerjes së punës.

Me ligjin e bazave të sigurisë së komunikacionit rrugor është e paraparë që pjesëmarrësit në komunikacion janë të detyruar të përmbahen kufizimeve, ndalimeve dhe obligimeve të shfaqura me anën e vendosjes së shenjave të komunikacionit (sinjalizimit), që janë paraparë me rregulloren për shenjat e komunikacionit dhe për shenjat që japin personat e autorizuar pjesëmarrësve të komunikacionit rrugor.

Janë planifikuar dy llojet e sinjalizimit të përkohshëm në komunikacion:

- sinjalizimi horizontal dhe
- sinjalizimi vertikal.

e.1. SINJALIZIMI HORIZONTAL

të gjitha shenjat horizontale që vendosen në sipërfaqen e asfaltuar duhet të kenë ngjyrë të **verdhë**. Shenjat gjatësore të rrugës janë vija të cilat vendosen paralel me boshtin e rrugës dhe shërbejnë për definimin e gjerësisë së rrugës së shfrytëzueshme.

Shenjat gjatësore të rrugës janë :

- a. vijat ndarese
- b. vijat anësore (të skajit)
- c. vijat udhëheqëse (udhërrefyese)

Në shenja tjera në sipërfaqe të rrugës numerohen:

- _ shigjetat
- _ fushat për drejtimin e komunikacionit
- _ vijat drejtuese
- _ shenjat në sipërfaqe me destinim të veçantë etj.

e.2. SINJALIZIMI VERTIKAL

e.2.1. TERMI I SINJALIZIMIT VERTIKAL

Termi i sinjalizimit vertikal në opinionin profesional me se shpeshti njihet si shenja të komunikacionit. Shikuar gjerësisht sinjalizimin vertikal mund të definohet si një përmbledhje e shenjave posaçërisht të koduara të dedikuara pjesëmarrësve në komunikacion të cilat në raport me sipërfaqen e rrugës vendosen në rrafshin vertikal.

e.2.2. ELEMENTET E SINJALIZIMIT VERTIKAL

Elementet themelore të sinjalizimit vertikal janë :

- _ shenja e komunikacionit
- _ mbajtësi i shenjës së komunikacionit dhe
- _ pjesët për lidhjen e shenjës për mbajtësin e saj

e.2.3. MADHËSIA E SHENJAVE

Madhësinë e shenjës së komunikacionit e karakterizojnë përmasat e sipërfaqes së figurës së shenjës: gjatësia, gjerësia përkatësisht diametri.

Madhësia e shenjave të komunikacionit është e ndryshme dhe është e varur drejtpërdrejt prej kategorisë së rrugës në të cilën është e vendosur.




Fig. e1. Forma dhe madhësia e shenjave

- ✓ Trekëndëshi: $a=90$ cm
- ✓ Rrethi ose tetëkëndëshi: $a=60$ cm
- ✓ Katroti: $a=60$ cm

e.2.4. SHTYLLA E SHENJËS SË KOMUNIKACIONIT

Shtylla e shenjës së komunikacionit me se shpeshti paraqet shtyllën e cila mundëson që shenja e komunikacionit të vendoset në sipërfaqen vertikale. Në parim mund të jete në formë dhe pamje të ndryshme, nuk janë të unifikuara zakonisht janë të definuar në disa forma të cilat përdoren për venjen e shenjës së komunikacionit.

e.2.5. VENDOSJA, MIRËMBAJTJA DHE INVENTARI I SINJALIZIMIT VERTIKAL

Projekti i sinjalizimit vertikal bazohet, kur është fjala për sinjalizimin standard vertikal, në përzgjedhjen dhe vendosjen e shenjave. Vendosja e shenjave, kombinimi dhe zgjedhja e shenjave në praktike është e njohur me termin "Vendosja e shenjave të komunikacionit".

Prej vendosjes së shenjave varet shumë edhe efikasiteti i tyre, nëse sinjalizimi vertikal nuk është në mënyrë adekuate i zgjedhur dhe drejtë i vendosur, shfrytëzuesit e rrugës janë të pa sigurt dhe bëjnë gabime në ngasje.

Vendosjen e shenjave mund ta shikojmë në dy aspekte: kushtet e komunikacionit për vendosjen e shenjës dhe rregullat për vendosjen e shenjave – zgjedhja e lokacionit

e.3. SPECIFIKACIONI

Në vijim paraqitja e shenjave të përkohshme që duhet të vendosen në rrugë gjatë punimeve për ndërtimin e urës, këto janë disa nga shenjat që janë paraqitur edhe në pjesën grafike.



Disa nga elementet që duhet të vendosen gjatë ekzekutimit të punëve

f. MENAXHIMI I TRAFIKUT - RAPORTI TEKNIK

Nga i gjithë materiali i cekur më lartë kemi ardhur në përfundim se Menaxhimi i trafikut përkatësisht rregullimi i qarkullimit në komunikacion në zonë në të cilën kryhen punimet në rrugë, mund të arrihet duke e mbyllur rrugën pjesërisht ose tërësisht për automjete të gjitha llojeve dhe duke i mundësuar qarkullimin përmes rrugëve alternative që paraqitur me projekt të veçantë në pjesën grafike.



Në kapitujt e më sipërm është cekur disa herë se siguria e pjesëmarrësve në komunikacion është primare, është planifikuar që preventiva të jetë elementare duke filluar nga sinjalizimi të jetë shumë efikas i përsëritur disa herë dhe me shenja të kualitetit të lartë, pastaj vendosja e shumë shenjave orientuese do ti ndihmon ngasësit për orientimin e lëvizjes për rrugët alternative, gjithashtu numri i shumë koneve dhe

cilindrave të trafikut duhet të vendoset përballë/përbri zonave të rrezikuar por konet nuk duhet të jenë ndërmjet njëri tjetrit më afër se 1,0 m. shtyllat me dritë vezulluese dhe shenjat reflektuese gjithsesi duhet të vendosen natën për sigurinë e komunikacionit.

Pasi që nga të gjitha hyrjet në zonën e punë ekzistojnë udhëkryqet, ngasësit duhet të informohen për drejtimin e lëvizjes në rrugët alternative.

Në vendet ku mund të bllokohet komunikacioni, qarkullimi përveç sinjalizimit ndriçues mund të rregullohet edhe më personat e autorizuar të cilët e rregullojnë komunikacionin me ndihmën e flamurëve të gjelbër dhe të kuq, e natën me shenja ndriçuese.



Nëse konstatohet se qarkullimi i automjeteve duhet të ndalohet plotësisht, rreth zonës mund të kalojnë vetëm këmbësoret duke pasur kujdes dhe duke respektuar kërkesat e punë kryesit.

Kur paraqitet domosdoshmeria e ofrimit të kalimit të këmbësorëve dhe të çiklistëve pranë apo përmes një pjese ku zhvillohen punimet sipas Kontratës atehere Kontraktuesi ofron rrugë kalime të përkohshme. Kur një numër i madhë i këmbësorëve duhet të kaloj atehere merren parasysh që atyre tu ofrohet një kalim i përshtatshëm i cili edhe është i mbrojtur.

Pas përfundimit të punimeve, të gjitha shenjat, pajisjet dhe mjetet tjera të kontrollit duhet të largohen.

N.N.T. SHKODRANI

Klinë